

KONTRATË

E lidhur me date: 02.05.2019.

KUVENDI I KOMUNES DRAGASHI, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

"Europrinty" Sh.p.k-Fushe Kosove (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

Furnizimi me material për dekorata në aktivitete të ndryshme për vitin 2019 me numër Identifikues **621-19-1226-1-3-6**, dhe nr. të brendshëm **621-2019-014-136**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **Furnizimi me material për dekorata në aktivitete të ndryshme për vitin 2019**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me **02.05.2019**, dhe përfundon me date **29.11.2019**(mvaresisht nga aktivitetet që do të zhvillohen përgjatë vitit 2019) nga data e urdherdhenjes për furnizim

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 3 ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i [kryerjes së furnizimeve] do të jetë **Drejtoria e Kultures-Dragash**

1.5 Incotermit i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

1.6. Menagjer i kontratës **Lirim Hajredini**

1.6. Menagjer i projektit(furnizimit) **Nexhat Tershnjaku**

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA E KOSOVES
Komuna e Dragashit
Opština Dragash
03 Nr. B. 400/01/-4729
02.05.2019
Dragash - Dragash

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **4,500.00 €; (kater mij e peseqind Euro).**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borbh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Pagesat do te kryen ne keste per sejcilin aktivitet qe do te zhvillohet, gjate tere vitit 2019 por deri ne vleren e kontrates 4500 €.

Kontrata do te paguhet pra ne disa keste

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimi të **secilës dërgesë-kest**], me nje raport te pergaditur nga Menagjeri i projektit dhe komisioni per pranim te mallit.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i **[furnizimeve]** duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj. pas pranimi **[furnizimeve]**

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [furnizimeve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në **Gjykatën themelore në Prizren, dega në Dragash** në pajtim me ligjin e Kosovës.


Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqip] [Serbisht] [Anglisht]² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	“ Europrinty” Sh.p.k- Fushe Kosove	Emri:	Nuro Ismaili
Pozita:		Pozita:	Zyrtar përgjegjës për komunikim
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	02.05.2019	Data:	02.05.2019
Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.



Republika e Kosovës/ Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit/ Opština Dragaš/ Dragash Municipality
Drejtoria Për Kulturë Rini e Sport



Specifikacion për aktivitetet gjatë vitit 2019

Nr.	Emri i produktit	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi per njësi	Cmimi total
1.	Furnizim me Kupë të madhe	Madhësi mes 40-45 cm, Kualiteti mesatar, dizajnimi i mbishkrimit nga ana e furnitorit	copë	9	14	126
2.	Furnizim me Kupë të mesme	Madhësi mes 35-40 cm, Kualiteti mesatar, dizajnimi i mbishkrimit nga ana e furnitorit	copë	9	12	108
3.	Furnizim me Kupë të vogël	Madhësi mes 30-35 cm, Kualiteti mesatar, dizajnimi i mbishkrimit nga ana e furnitorit	copë	9	8	72
2.	Furnizim me topa futbollit	Kualiteti i lartë	copë	12	10	120
3.	Furnizim me topa volejbollit	Kualiteti i lartë	copë	3	5	15
4.	Furnizim me topa basketbollit	Kualiteti i lartë	copë	4	15	60
5	Furnizim me raketa ping-pongu	Kualiteti mesatar	copë	8	2.5	20
6.	Furnizim me bluza (maica) me jaka me mbishkrim	Kualiteti i lartë , dizajnimi i mbishkrimit nga ana e furnitorit	copë	20	4	80
7.	Furnizim me bluza (maica) pa jaka me mbishkrim	Kualitet mesatar	copë	180	2.3	414
8.	Furnizim me medalje me mbishkrim	Kualitet mesatar, dizajnimi i mbishkrimit nga ana e furnitorit	copë	180	1.5	270
9.	Furnizim me banera (cerada) me mbishkrim	Kualitet mesatar, dizajnimi nga ana e furnitorit (4 m * 2m)	cope	8	40	320
10.	Furnizim me banera (cerada), roller me mbishkrim	Kualitet mesatar, dizajnimi nga ana e furnitorit 85cm * 2m	cope	3	25	75
11.	Furnizim me romane	Titujt përcaktohen në	copë	500	1.5	750

		aneks				
12.	Furnizim me lektyra shkollore	Titujt përcaktohen në aneks	copë	1500	1	1500
13.	Furnizim me stilolapsa me mbishkrim	Kualitet mesatar, dizajnimi i mbishkrimit nga ana e furnitorit	copë	100	0.3	30
14.	Furnizim me flamura të thjeshtë 1x2	Kualitet mesatar, 1x2	copë	10	3	30
15.	Furnizim me flamura të mëdhenj 2x2	Kualiteti i lartë, 2x2	copë	8	10	80
16.	Furnizim me mirënjohje	Formati A3 dhe A4, Shtypi color, letra 300 gr mat. dizajnimi nga ana e furnitorit	copë	100	0.3	30
18.	Furnizim me mirënjohje	Mirënjohje kuti, kualiteti i lartë, shtypi ne pllak, dizajnimi nga ana e furnitorit	copë	15	19	285
19.	Furnizim me kese letre me mbishkrim	Shtypi color, dizajni nga ana e furnitorit – A3	copë	40	1.5	60
20.	Furnizim me ftesa	A5, Letër 300 gr, mat, color, dizajnimi nga ana e furnitorit	copë	200	0.2	40
21.	Pllakata A3	A3, Letër 80 gr, color dizajni nga ana e furnitorit	copë	150	0.1	15
		TOTAL:			4500.00€	

• Verejtje Furnizimi dhe pagesat do te behen neper faza te ndryshme varesisht kur edhe mbahen aktivitetet kulturore ateher edhe do te kerkojm(nga njesia kerkuese-Drejtoreti per kulture) qe te na furnizoni, por gjithemon deri ne sasin sipas tenderit.